



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 622/5 Prot

Tiranë, më 07.09.2021

V E N D I M

Nr.103, datë 07.09.2021

Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë kryerjes së transferimit të përkohshëm, si dhe lirimit nga shërbimi civil të nëpunës ***.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësja *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 622 prot., datë 18.05.2021, nëpunësja ***** , parashtron se ndaj saj janë marrë disa vendime për transferim të përkohshëm, të cilat të mbledhura së bashku kanë kaluar edhe afatin 6-mujor të transferimit brenda periudhës 2-vjeçare, sipas përcaktimit ligjor.

Aktualisht, me urdhrin nr. 159, datë 27.05.2021 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, të Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz, është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për shkak të mosparaqitjes në punë për 3 ditë radhazi në mënyrë të pajustificuar.

Nga verifikimi i kryer për këtë rast, rezulton se nëpunësja ***** , me aktin nr. 13 prot., datë 26.07.2018, është emëruar në pozicionin “Specialiste Arkiv-protokollit”, në Bashkinë Fushë Arrëz, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit. Pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr. 1404 prot., datë 09.05.2019, të njësisë përgjegjëse, është përmblyllur procesi, duke u deklaruar nëpunës civil në këtë pozicion.

Konstatohet se, pak kohë pas konfirmimit si nëpunës civil, nëpërmjet urdhrit nr. 189, datë 09.07.2019 “Për ndryshim pozicioni”, të Kryetarit të Bashkisë, nëpunësja është transferuar në pozicionin “Specialiste pagash dhe kontributesh” në Bashkinë Fushë Arrëz, detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin kur, me urdhrin nr. 268, datë 03.09.2019 “Për lëvizje paralele”, të Kryetarit të Bashkisë, është transferuar në pozicionin “Specialiste Auditit të Brendshëm”, për shkak të vakancës së këtij pozicioni dhe nevojës për përmbushjen e detyrave të institucionit.

Më tej, me urdhrin nr. 417, datë 18.12.2019 “Për ndryshim pozicioni”, Kryetari i Bashkisë ka miratuar transferimin e saj, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave”, në Bashkinë Fushë Arrëz, transferim që ka zgjatur deri kur, me aktin e Kryetarit të Bashkisë nr. 142, datë 18.05.2021 “Për ndryshim pozicioni”, është urdhëruar sërish transferimi i nëpunëses ***** në pozicionin “Specialiste e Arkiv-protokollit”, pranë njësisë administrative Blerim.

Pretendimet për paligjshmëri gjatë kryerjes së veprimeve administrative, të parashtruara nga nëpunësja *****, konsistojnë në faktin se është tejkualuar afati 6-mujor i transferimit brenda një periudhe 2-vjeçare, sipas përcaktimit të ligjit.

Duke shqyrtuar aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të këtij rasti, rezulton se:

Së pari, lëvizja në detyrë e nëpunëses në fjalë është kryer me një akt të drejtuesit të institucionit, pa respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kushtet e Vendimit nr. 125, datë 17.02.20116, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Konstatohet se çdo urdhër i Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, për transferimin e nëpunëses *****, është kryer duke shënuar si bazë ligjore Kodin e Punës, si dhe dispozitat për funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore. Ky veprim i bën aktet e transferimit të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, të kundraligjshme nga pikëpamja formale e referencës ligjore, për arsye se aktet e transferimit për nëpunësin civil, duhet t’i referohen legjisllacionit të shërbimit civil dhe terminologjisë së tij.

Së dyti, pretendimi i ngritur për tejkualimin e afatit 6-mujor të transferimit, brenda periudhës 2-vjeçare, është i drejtë. Edhe në qoftë se aktet e mësipërme do të pranoheshin si të sakta nga pikëpamja formale, transferimet për nevoja pune duhej të ishin kryer duke respektuar kushtin e pikës 1/a të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr.125, datë 17.02.20116 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht, në dispozitat e Kreut I, pika 2/“a” e vijues, të vendimit nr. 125, datë 17.02.20116 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Këshillit të Ministrave përcaktohet se, nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në

një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori: **a)** në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje gjatë 2 viteve... dhe **b)** miratim të njësisë përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar, rezulton se nëpunësja në fjalë, pasi ka fituar statusin e punësimit (datë 09.05.2019), është transferuar përkohësisht nëpërmjet urdhrin nr. 189, datë 09.07.2019 të Kryetarit të Bashkisë, për një periudhë **2 muajore** në pozicionin “*Specialiste pagash dhe kontributesh*”.

Më tej, rezulton se me aktin nr. 268, datë 03.09.2019 “*Për lëvizje paralele*”, Kryetari i Bashkisë, për nevoja të institucionit, ka miratuar edhe një transferim të përkohshëm në pozicionin “*Specialiste Auditit të Brendshëm*”, transferim i cili ka përfunduar në datën 18.12.2019 (pas **3 muajsh**), kur është transferuar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave*”. Në këtë pozicion nëpunësja ka punuar për **17 muaj**, moment kur, me aktin nr. 142, datë 18.05.2021, është urdhëruar ndryshimi i pozicionit të punës në “*Specialiste e Arkiv-protokollit*”, pranë njësisë administrative Blerim.

Nga analiza e mësipërme, konstatohet se është tejkaluar afati ligjor i lejuar për transferimet e përkohshme, që është parashikuar në dispozitën e cituar më sipër (22 muaj, gjithsej). Për më tepër, transferimi me urdhrin nr. 417, datë 18.12.2019 “*Për ndryshim pozicioni*”, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave*”, në Bashkinë Fushë Arrëz, ka tiparet e ngritjes në detyrë, fakt që përbën një tjetër shkelje flagrante të legjisllacionit të shërbimit civil, konkretisht të kushtit të përcaktuar në pikën 1/a, të nenit 48 “*Transferimi i përkohshëm*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në të cilin thuhet shprehimisht:

“Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë dy viteve...”

Nisur nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme, rezulton se janë transferime të përkohshme për nevoja të institucionit, të bazuara në ligj, vetëm ato që përfshihen brenda fashës 6 muajore, nga transferimi i parë (konkretisht, transferimi me aktin nr. 189, datë 09.07.2019, në pozicionin “*Specialiste pagash dhe kontributesh*” dhe transferimi me aktin nr. 268, datë 03.09.2019, në pozicionin “*Specialiste Auditit të Brendshëm*”), kurse veprimet e tjera administrative, meqenëse janë kryer në kundërshtim me ligjin material, bazuar në nenin 109, pika “d”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave administrative i RSH*”, janë veprime administrative të paligjshme, të cilat në bazë të nenit 113 të këtij kodi, duhet të anulohen nga vetë organi publik.

Në këto rrethana, nëpunësja duhet të rikthehet në detyrë sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 12, të vendimit nr. 125, datë 17.02.20116 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit “*Kthimi në vendin*

e punës bëhet nga njësia përgjegjëse pas mbarimit të afateve të parashikuara në vendimin e njësisë përgjegjëse dhe jo më vonë se afatet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi”.

Duke vazhduar me analizën e rrethanave të çështjes, konstatohet se me urdhrin nr.159, datë 27.05.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”*, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve të punës për punonjësën *****, me motivacionin *“Mos paraqitje në punë për 3 (tre) ditë radhazi dhe në mënyrë të pajustificuar”*, për datat 24-27 Maj 2021.

Nga përmbajtja e aktit të mësipërm, shkak i nxjerrjes së aktit për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, është konstatimi i një mungese të pajustificuar të nëpunëses *****, prej tre ditësh dhe kjo është vlerësuar e mjaftueshme për të urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me urdhër të titullarit.

Nga këqyrja e akteve të administruara rezulton se, pasi është njohur me urdhrin për kalimin në pozicionin *“Specialiste e Arkiv-protokollit”*, pranë njësies administrative Blerim, me nr. 142, datë 18.05.2021 *“Për ndryshim pozicioni”*, në datën 19.05.2021 nëpunësja ***** ka paraqitur një *“Ankesë”* drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe Njësies së Burimeve Njerëzore të institucionit, me anë të së cilës kundërshton ndryshimin e pozicionit të punës.

Nisur nga fakti se nuk kishte asnjë reagim lidhur me ankesën si më sipër, me anë të shkresës datë 28.05.2021 *“Kërkesë për informacion”*, drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe Burimeve Njerëzore të institucionit, nëpunësja ka kërkuar sqarim lidhur me mungesën e përgjigjes ndaj ankesës së saj.

Kujtojmë këtu se, në Kreun I, të vendimit nr. 125, datë 17.02.20116 *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, të Këshillit të Ministrave, parashikohet se në rastet e transferimit të nëpunësit: *“Nëpunësi civil ka të drejtë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të refuzojë me shkrim transferimin e përkohshëm pranë njësies përgjegjëse dhe të dëgjohet prej saj”* dhe, *“mbi këtë bazë Njësia përgjegjëse merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 9 të këtij vendimi”*.

Pra, pretendimi i nëpunëses në fjalë, se nuk ishte dakort me trasferimin e fundit e për këtë, meqënëse kishte paraqitur ankim, priste një përgjigje nga njësia përgjegjëse, është një veprim i ligjshëm që nuk duhet të konsiderohet si shkelje disiplinore.

Nga ana tjetër, edhe nëse mungesa në punë për tre ditë, e punonjësës ***** do të konsiderohej se jemi para një shkelje disiplinore, ajo duhej të trajtohej sipas nenit 57 e vijues, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 115, datë 05.3.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin,*

përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, ku përcaktohen hapat që duhet të ndiqen në rastet e konstatimit të shkeljeve disiplinore nga nëpunësi civil.

Nga këqyrja e akteve të administruara, nuk konstatohet të jetë kryer ndonjë veprim lidhur me shkeljen e pretenduar, por apriori mungesa në detyrë e punonjësës është konsideruar si shkelje shumë e rëndë e disiplinës në punë dhe për këtë, Kryetari i Bashkisë, me urdhrin nr. 159, datë 27.05.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,* ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Akti nr. 159, datë 27.05.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,* i Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, bazuar në pikën 1, germa i) dhe ii), të nenit 108 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave administrative i RSH”,* është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak se është nxjerrë në mungesë të kompetencës së organit publik dhe procedurës së përcaktuar në ligj. Në rastet e shkeljeve shumë të rënda të disiplinës, kompetenca për marrjen e masës disiplinore i takon Komisionit të Disiplinës, sipas procedurës së përcaktuar në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 115, datë 05.3.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”.*

Shkelja e rregullave të përmendura më sipër, bëjnë që akti nr. 159, datë 27.05.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,* i Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, të jetë një akt absolutisht i pavlefshëm, i cili në bazë të nenit 110, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave administrative i RSH”,* nuk sjell asnjë pasojë juridike, pasi konsiderohet se nuk ekziston.

Nga sa analizuam më sipër, arrijmë në përfundimin se aktet e transferimit të nxjerra pas transferimeve të para, që tejkalojnë periudhën 6 mujore, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, janë akte të kundraligjshme të cilat duhet të anulohen nga vetë organi publik që i ka nxjerrë. Në të njëjtën kohë, bazuar në nenin 111, i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave administrative i RSH”,* organi publik që ka nxjerrë aktin, pra Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, ka detyrimin që të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 159, datë 27.05.2021 *“Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”,* për nëpunësen ***** dhe në fund, njësia përgjegjëse duhet të nxjerrë aktin për kthimin e nëpunëses ***** në pozicionin ku ajo ka emërimin e rregullt.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”,* i ndryshuar, nenet 108, pikat i) dhe ii), 110, 111 dhe 113 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,* si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,*

miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, të anulojë aktet e transferimit: urdhrin nr. 417, datë 18.12.2019 “Për ndryshim pozicioni” dhe urdhrin nr. 142, datë 18.05.2021 “Për ndryshim pozicioni”, si akte që vijnë në kundërshtim me një dispozitë materiale të ligjit.
2. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 159, datë 27.05.2021 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për shkak të tejkalimit të kompetencës dhe shkelje të procedurës së përcaktuar në ligj dhe të rregullohen pasojat që kanë ardhur në lidhje me cenimin e marrëdhënies së punës dhe atë financiare për punonjësen *****.
3. Pasi të kryhen veprimet e anulimit të akteve si më sipër nga ana e organit publik (Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz), Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Fushë-Arrëz duhet të nxjerrë aktin për rikthimin e nëpunëses ***** në pozicionin “Specialist arkiv-protokoll”, pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, ku ajo ka emërimin e rregullt.
4. Ky vendim duhet të zbatohet brenda një afati **30** ditor, nga momenti i komunikimit të tij. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Fushë Arrëz dhe punonjësja *****.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha